

AKTI THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
" Sphere Law and Consulting" SH.P.K

Znj. Fjoralba PRIFTI, e bija e Fadilit, lindur Kukës më 05.06.1977, banuese në Tiranë, Bulevardi Zhan Dark, Pall Wonder, Nd.1, Hyrja 1, ap 13, Njesia administrative nr. 2 me Numer Personal H75605043E, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

Në mbështetje të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", pasi u mblohd sot në Tiranë më datë 21.09.2023

VENDOSI:

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim harton dhe miraton këtë akt themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon.

Neni 1

Emri i shoqërisë

- 1.1 Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin " Sphere Law and Consulting" SH.P.K.
- 1.2 Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me miratimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Saj.

Neni 2

Forma e shoqërisë

- 2.1 Shoqëria tregtare " Sphere Law and Consulting" SH.P.K ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).
- 2.2 Shoqëria mund të trasformohet në një formë tjeter me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas përcaktimeve ligjore ose të Statutit.

Neni 3

Selia



3.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në në Tiranë, në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 1, Kat.5, Ap.10.

3.2 Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve të shoqërisë .

3.3 Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë ë tsaj , apo Zyra Përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

Neni 4

Vula e shoqërisë

4.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj .

4.2 Forma e Vulës dhe masa e saj përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 5

Objekti i Veprimtarisë

5.1 Shoqëria ka si objekt veprimtaritë që vijon më poshtë:

a) Realizimin e shërbime juridike si konsulencë juridike, përfaqësim pranë organeve publike si dhe në çdo procedurë administrative që klienti është përfshirë apo përfshihet, përfaqësim në procesin gjyqësor penal, civil, administrativ, kushtetues ose të ndonjë natyre tjetër, në çdo shkallë të gjyqësorit, brenda ose jashtë vendit, pranë gjykatave ndërkombëtare, ose çdo organizmi tjetër pranë të cilil Republika e Shqipërisë ka aderuar, si dhe përfaqësim në procedurat e ndërmjetësimit ose të arbitrazhit, vendase, të huaja apo ndërkombëtare, përgatitjen e kërkesëpadive ose të kërkesave gjatë proceseve gjyqësore, si dhe te kërkesave ankimore, rekurseve kundër vendimeve gjyqësore, atyre te organit të prokurorisë, arbitrazhit ose te organeve të administratës publike, përgatitjen e kërkesave drejtuar Gjykatës Kushtetuese. gjykatave ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë, përgatitjes së ankesave dhe kërkesave për klientin, përpilim të akteve që i nënshtrohen veprimeve notierale, hartim të kontratave e. të marrëveshjeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike, hartim të çdo dokumenti shkresor sipas kërkesave dhe porosive të klientit, kryerjen e veprimeve të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar ose në legjislacion e huaj, kur veprimtaria kryhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

Neni 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë 100 000 (njeqind mijë) lekë, e perbere nga 1 kuotë me vlerë 100 000 lek, e zoteruar e gjitha nga Znj.Fjoralba Prifti.

7.2 Ortakët në bazë të kërkesës së organit administrues mund të sjellin para në shoqëri , sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit , ashtu edhe në formën e financimit të shoqërisë . Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje nuk është e nevojshme të respektohen proporcionaliteti mes shumës së derdhur dhe kuotave të kapitalit që ortakët zoterojnë.

7.3 Nëse midis palëve nuk ka akorde specifike , financimet në formë huaje të bëra nga ortakët do të kondiserohen hua pa interes.

Neni 8

Organet e shoqërisë

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2. Kompetencat , të drejta dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administratori

9.1 Shoqëria administrohet nga administratori që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje.

9.2 Administrator i Shoqërisë do të jetë znj. Fjoralba PRIFTI , e bija e Fadilit, lindur Kukës më 05.06.1977, banuese në Tiranë, Bulevardi Zhan Dark, Pall Wonder, Nd.1, Hyrja 1, ap 13, Njesia administrative nr. 2, me Numer Personal H75605043E, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

Neni 10



Dispozitat e fundit

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit dhe në Statut do të gjejnë gjejnë zbatim dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve


11.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet zgjidhja me mirëkuptim, në rast të kundër kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 12

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortaku themelues .

Tiranë më 21.09.2023.

ORTAKU THEMELUES

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Goralla Drifti". The signature is fluid and cursive, with "Goralla" on top and "Drifti" below it, though the order is reversed from standard reading.